



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr. 70/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, parashtruar kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, lidhur me parregullsitë gjatë votimit me postë për votuesit jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.01.2026, merr këtë :

VENDIM

KONSTATOHET E TËRHEQUR ankesa e parashtruar nga Subjekti Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, ZP. A.nr.70/2025, e datës 09.01.2026, të paraqitur kundër Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, lidhur me parregullsitë gjatë votimit me postë për votuesit jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 28 Dhjetor 2025.

Arsyetim

Më datë 09.01.2026 në PZAP-i, është pranuar një ankesë parashtruar nga subjekti Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), në të cilën ka theksuar se më dt. 18.12.2025, B.T anëtar dhe mbështetës i PLE në mërgatë, respektivisht Gjermani, ka publikuar një video në facebook ku shihet, dhe deklaroi vet ai, se është duke plotësuar fletëvotimet e personave të regjistruar për votim nga mërgata dhe me këtë, PLE ka shkelur të drejtën e votës, fshehtësinë e votës dhe ka ndikuar në vullnetin e votuesit sipas nenit 6, paragrafi 2 të Ligjit nr. 08/L.,228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. I njëjti thekson se PZAP, ankesën e IRDK-së, e ka pranuar si të bazuar, dhe subjektit politik PLE i ka shqiptuar dënimin me gjobë prej 2,000.00 e, për shkakun e lartcekur, duke mos i dhënë as të drejtë ankese. I njëjti thekson se konfirmimi i këtij fakti, përmes vendimit ZP,Anr. 29/2025 të PZAP, pra shkelja e një të drejte të ndjeshme siç është e drejta votës dhe ndikimi në vullnetin e votuesit, humbë legjitimitetin e votës së mërgatës për subjektin politik PLE dhe përbën bazë juridike për anulimin e kësaj vote, pasi që rezultati zgjedhor mbetet i ndikuar nga një proces i paligjshëm, cenohen parimet kushtetuese të barazisë së votës dhe garës së ndershme. Me këtë rast ka kërkuar që të anulohen votat me postë të Partisë Liberale Egjiptiane dhe të urdhërohet KQZ-në që të mos përfshijë votat me postë në rezultatin

përfundimtar të zgjedhjeve, si dhe të ndermirën çdo masë tjetër ligjore të nevojshme për garantimin e integritetit dhe ligjshmërisë së procesit zgjedhor.

Pas paraqitjes së ankesës, mirëpo para shqyrtimit meritore të njëjtës, ankuesi me parashtresën e datës 09.01.2026, me Nr. Protokolli ZP. A.nr.70-4/2026 përmes përfaqësuesit të subjektit politik IRDK ka njoftuar PZAP që për shkaqe subjektive tërhiqet ankesa e parashtruar në PZAP me numër ZP A.nr. 70/2026 e datës 09.01.2026

Prandaj PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës, në kuptim të nenit 11 paragrafi 8 i Rregullores nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijs së Ankesave të PZAP-së, si dhe nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZP.Anr.70/2026, datë 12.01.2026

